

Titulli i lëndës:

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë		
Titulli i lëndës:	Semiotikë		
Niveli:	Bachelor		
Statusi i lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	Bachelor, Semestri VI		
Numri i orëve në javë:	2+0		
Kreditë ECTS:	6		
Koha / Vendi:	Departamenti i Gjuhës Shqipe, Fakulteti i Filologjisë Sipas orarit.		
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Shkumbin MUNISHI		
Të dhënat kontaktuese:	shkumbin.munishi@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	Lënda mësimore përqendrohet në studimin e shenjave dhe dukurisë së shenjueshmërisë në përgjithësi si formë e komunikimit. Në këtë lëndë paraqiten njohuri të përgjithshme për studimet semiotike dhe për shenjat. Po ashtu, ofrohen informata themelore e konceptore lidhur me komunikimin dhe me rolin që luajnë shenjat në komunikim.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që studentët të njihen me gjerësisht për shenjat dhe për funksionimin e tyre në kuadër të komunikimit, si dhe të njihen me disiplinë që merret me studimin tyre, e cila njihet me emrin semiotikë. Në kuadër të kursit studentët do të marrin informacione të përgjithshme mbi shenjat, funksionet e tyre dhe për natyrën e tyre. Në mënyrë specifike, ata do të njihen me llojet e shenjave, me ndarjet dhe nëndarjet e tyre sipas, autorëve të tyre, dhe me lidhjen e shenjave me të gjitha format e komunikimit njerëzor.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jenë në gjendje që:		
	• ta kuptojë natyrën e shenjave, funksionimin e tyre në komunikim dhe rolin që kanë shenjat në jetën e njerëzve.		
	• ta kuptojë natyrën e shenjave, funksionimin e tyre në komunikim dhe rolin që kanë shenjat në jetën e njerëzve.		
	• ta kuptojnë ndërtimin e shenjave, funksionimin e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e përditshme të njerëzve.		
	• t'i njohin llojet e shenjave, nëndarjet e tyre dhe teoritë kryesore për shenjat.		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30

Teori / Punë në laborator / Ushtrime	1	15	15
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	12 minuta për student në javë	15	12 x 15 = 180, 3 orë
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	3	6
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	5		5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.			
Totali			90.00 orë 6 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, seminare dhe detyra.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 25% Vlerësimi i dytë: 30% Detyrat e shtëpisë : 10% Vijimi i rregullt: 5% Provimi final: 30% Total: 100%
Literatura primare:	De Saussure, Ferdinand (1972). Kursi i gjuhësisë së përgjithshme. Rilindja. Prishtinë. 1972. Bot. II. Tiranë. Dituria. 2002. Ismajli, R. (1974). Shenjë e ide, Rilindja, Prishtinë, 1974. Barthes, Roland (1991). Avantura Semilogjike, Prishtinë. Eco, Umberto, Struktura e papranishme, Dukagjini, Pejë.
Literatura shitesë:	Brown, Martin and Ringham, Felizitas (2000). Dictionary of Semiotics, Casell, London and New York. Chandler, Daniel (2002). Semiotics – the basics, Second Edition, Routledge, London and New York, 2007. Cobley, Paul and Jansz, Rita (1997). Introducing Semiotics, Totem Books USA and Icon Books UK, This edition published by Icon Books UK. Danesi, Marcel (2004). Messages, Signs and Meanings, A Textbook in Semiotics and Communications, 3rd edition, Canadian Scholar's Press Inc, Toronto.

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjërates
Java 1:	Ç'është semiotika? (historiku i semiotikës, shenjat).
Java 2:	Teoria themelore e shenjës (përshkrimi i shenjës, ikona, indeksi, simboli, kultura).
Java 3:	Shenjat trupore (sinjalet, shprehjet e fytyrës, kontakti me sy, gjuha trupore, prekja, gjestet, vallëzimi).
Java 4:	Shenjat vizuale (imazhet mendore, ngjyrat, përfaqësimet vizuale, hartat, artet vizuale, kinemaja).

Java 5:	Gjuha (nxënia e të folurit, fjalët, emrat, komunikimi verbal, shkrimi, arti verbal).
Java 6:	Emrat dhe foljet.
Java 7:	Metafora (konceptet për metaforën, metonimia dhe ironia, metafora dhe kultura). Mitet dhe narracioni .
Java 8:	Semiotika e artit (teatri, muzika, arti postmodern).
Java 9:	Veshja (kodi i veshjes, lakuriqësia, moda) Ushqimi (ushqimi si simbolizëm, kodi i ushqimit, fast food-i).
Java 10:	Objektet (teknologjia, kompjuterët, pop arti, bota digjitale).
Java 11:	Hapësira dhe ndërtesat (kodi hapësinor, arkitektura).
Java 12:	Mediet: televizioni, radio dhe Interneti si mekanizma të shenjueshmërisë.
Java 13:	Shenjuershmëria e reklamave (firmat dhe logot, gjuha e reklamave, kultura e reklamave).
Java 14:	Komunikimi (komunikimi i kafshëve, komunikimi njerëzor).
Java 15:	Konceptet për shenjën sipas autorëve të ndryshëm: ngjashmëri dhe krahasime.

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët duhet t'i ndjekin me rregull ligjëratat. Në rast të mungesave të shumta të paarsyeshme studentëve nuk do t'u verifikohet pjesëmarrja e rregullt në ligjëratat e ushtrime. Prania e studentëve në ligjëratat dhe në ushtrime shënohet në fletët e evidencës.

Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t'i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave dhe provimeve.